



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

E drejta e Azilit dhe Legjislacioni në Fuqi

Trajnuese:

Delushe Halimi-Gjyqtare në Gjykatën e Apelit

Prishtinë, 11.10.2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja e këtij moduli është e AD-së, ndërsa pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë.

Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Tabela e përmbajtjes

HYRJE

Hyrje	1
Objektivat mësimore	4
Metodat e të mësuarit	4
Pritjet nga pjesëmarrësit	4
Burimet dhe literatura	4
Ligji për Azilin	5
Hyrja dhe ndihma për Azilkërkuesin në Republikën e Kosovës	6
Procedurat, standardet e shqyrtimit dhe marrjes së vendimit lidhur me kërkesën për azil	8
Organet kompetente për vendosjes e kërkesë për Azil	9
Procedura e Ankesës	11
Mbrojtja Plotësuese	12
Konflikti administrativ në çështjet e të drejtës së Azilit,	14
Mjetet juridike në procedurën gjyqësore në Konflikt Administrativ	15
Karakteret e Detyrueshëm i Aktgjykimit në Konfliktin Administrativ	18

Hyrje

Në këtë trajnim, pjesëmarrësit do të njihen me dispozitat ligjore në fuqi dhe zbatimin e tyre në praktik me rastin e vendosjes për të drejtën e azilit. Do të trajtohet veçmas procedura administrative që zhvillohet pranë organit administrativ Departamentit për Shtetësi Azil dhe Migrim si organ i shkallës së parë, Komisionit Kombëtar për Refugjat si organ i shkallës së dytë, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si organ kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën e azil kërkuesve të njohjen e të drejtës së Azilit.

Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Identifikojnë dhe interpretojnë drejtë dispozitat ligjore në fuqi për të drejtën e Azilit në Kosovë.
- Zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Azilin të Kosovës, me rastin e vendosjes në çështjet e azilit.
- Të kuptojnë drejtë procedurën administrative e cila zhvillohet pranë organit administrativ lidhur me trajtimin e kërkesave për azil.
- Të zbatojnë drejtë dispozita ligjore të Ligjit për Konfliktin Administrativ, në rastet e padive që kanë të bëjnë me të drejtën e Azilit.

Metodologjia trajnuese

Ndër metodat kryesore që do të përdoret gjatë trajnimit janë: ligjërimi teorik, diskutime interaktive, të cilat do të përmbajnë edhe argumentet dhe komentet e ndryshme si dhe kritikën eventuale nga pjesëmarrësit lidhur me temën e cila po trajtohet. Do të trajtohen dispozitat ligjore si dhe raste praktike. Materiali teorik është strukturuar në mënyrë që koha më e madhe është siguruar për debate dhe diskutime me pjesëmarrësit.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Në këtë trajnim pjesëmarrësit do të njihen specifikisht me dispozitat e Ligjit për Azilin në Kosovë dhe aktet nënligjore, procedurën e azilit, rolin e palëve në procedurë dhe gjithë atë çfarë i paraprin deri në marrjen e vendimit përfundimtar dhe Ligjin për Konfliktet Administrative e veçmas pjesën që ka të bëjë me procedurën për çështjen e Azilit, ku nga pjesëmarrësit pres që pas përfundimit të këtij prezantimi kanë përvetësuar njohuri lidhur me zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me procedurën lidhur me kërkesën e azilkërkuesve të ushtruar pranë Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komisionit Kombëtar për Refugjatë të Kosovës si dhe për inicimin i Konfliktit Administrativ dhe procedurat pranë gjykatës kompetente.

Burimet dhe literatura

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës,
- Konventa e OKB-së, e vitit 1951,
- Ligji për Azilin i Kosovës dhe aktet nën ligjore,
- Ligji për Konfliktin Administrativ,

Ligji për Azilin

Në republikën e Kosovës, institutin e Azilit e rregullon në mënyrë detale Ligji për Azilin i Kosovës Nr. 06/L-026 i datës 30 mars 2018, i cili ka hyrë në fuqi më 15 maj 2018.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës Institutin e azilit, nuk e ka paraparë në asnjë dispozitë të sajë, mirëpo ky institut gjen zbatim në mënyrë të tërthortë nëpërmes akteve ndërkombëtare që janë drejtë për drejtë të zbatuara në Kosovë, përmes nenit 22 të Kushtetutës.

E drejta e Azilit në shtetet evropiane është e rregulluar në mënyra të ndryshme, dhe kjo si pasojë e politikave të ngushta nga ana e shteteve sovraane. Statusi i refugjatit, rregullohet në nivel botëror nga Konventa o OKB-së e vitit 1951 dhe protokollit të vitit 1967 në lidhje me statusin e refugjatëve. Këto dy instrumente ligjore ndërkombëtare janë miratuar në kuadrin e OKB-së.

Në vitin 1951, është nënshkruar Konventa e Gjenevës, lidhur me statusin e refugjatëve, me këtë rast vendet që e ratifikojnë këtë konventë kanë për obligim që njerëzit që janë detyruar të largohen nga përndjekjet t'iu ofrohet azil apo mbrojtje dhe strehim.

Republika e Kosovës, ende nuk është anëtare e Bashkimit Evropian, kështu që për momentin e drejta e BE-së, nuk paraqet të drejtë obligative. Mirëpo, duke marrë parasysh Marrëveshjen për stabilizim-asocim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, si dhe programet nacionale të Republikës së Kosovës në proceset e integritimit evropian, ekziston obligimi i harmonizimit në hapa të legjislacionit nacional me të drejtën e BE-së.

E drejta ndërkombëtare dhe e Drejta e BE-së, kanë zhvilluar një lëmi të rëndësishme juridike, qëllimi i së cilës është qasja e barabartë ndaj personave të cilët për shkak të frikës ikin nga shteti i shtetësisë ose vendbanimit të tyre sepse atje u është rrezikuar jeta apo i janë nënshtruar trajtimit çnjerëzor. Procedurat të cilat duhet të udhëhiqen për pranimin e statusit dhe të drejtave të azilit dhe bartësve të tjerë të mbrojtjes ndërkombëtare, duhet të zbatohen në pajtim me direktivat për kualifikimet dhe procedurat si dhe konform përmbajtjes së tyre duhet të inkorporohen në legjislacionin nacional.

Republika e Kosovës, këtë institut e rregullon me një Ligj i cili është në pajtueshmëri me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Kosova me nxjerrjen e këtij Ligji është futur në mesin e shumë shteteve demokratike që me anë të legjislacionit të vetë të aplikueshëm e kanë rregulluar këtë çështje juridike dhe kanë përmbushur një obligim shumë të rëndësishëm ndërkombëtarë.

Ky ligj ka për qëllim që të harmonizohet me:

- Direktivën Nr. 2013/33/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 26 qershor 2013 për Vendorsjen e Standardeve të Pranimi të Aplikuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare;
- Direktivën Nr.2013/32/EU Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 26 qershor 2013 mbi Procedurat e Përbashkëta për Dhënien dhe Tërheqjen e Mbrojtjes Ndërkombëtare;

- Direktivën Nr.2001/55/EC e Këshillit e datës 20 korrik 2001 mbi Standardet Minimale për Dhënien e Mbrojtjes Ndërkombëtare në rast të Fluksit Masiv të Personave të Zhvendosur dhe mbi Masat që Promovojnë një Balans të Përpjekjeve të Shteteve Anëtare në Pranimin e Personave të tillë dhe Bartjen e Pasojava nga kjo;
- Direktivën Nr. 2011/95/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 13 dhjetor 2011 mbi Standardet për Kualifikim të Shtetasve të Vendeve të Treta apo Personave pa Shtetësi si Përfitues të Mbrojtjes Ndërkombëtare për një Status Unik për Refugjatët apo për Persona të Përshtatshëm për Mbrojtje Ndërkombëtare si dhe për Përmbajtjen e Mbrojtjes së Dhënë;
- Direktiva Nr.2011/51 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 majit 2011 për Ndryshimin e Direktivës së Këshillit 2003/109 / EC për Zgjerimin e Fushëveprimit të saj për Përfituesit e Mbrojtjes Ndërkombëtare;
- Direktiva Nr. 2003/86/EC e Këshillit të Bashkimit Evropian e datës 22 shtator 2003 mbi të Drejtën e Ribashkimit Familjar.

Me dispozitat e Ligjit për Azilin, me azil nënkuptohet mbrojta që Republika e Kosovës i ofron personave të huaj apo personale pa shtetësi. Azili përfshin të drejtën për vendqëndrim në territorin e Kosovës si dhe të drejtat e tjera që parashihen me këtë ligj. Azil kërkues-është i huaji i cili e ka parashtruar kërkesën e tij ose të sajë për azil apo mbrojtje plotësuese. Ai konsiderohet i tillë që nga momenti i parashtrimit të kërkesës për azil e deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Hyrja dhe ndihma për Azilkërkuesin në Republikën e Kosovës

Në Republikën e Kosovës, i huaji i cili deklaron qëllimin e tij për parashtrimin e kërkesës për azil, do të trajtohet si azil kërkues në pajtim me këtë Ligj, pra ai do të lejohet të hyjë në territorin e Republikës dhe do të ndihmohet dhe njoftohet për procedurën e cila i paraprin kërkesës për njohjen e azilit. Gjithashtu edhe i huaji i cili hyn ilegalisht në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të parashtrimit të kërkesës për azil, duhet të i parashtroj pa vonesë kërkesën për azil, pranë organit kompetent.

Nuk do të dënohet azil kërkuesi për hyrje ilegale, qoftë duke ju shmangur doganës/inspektimit të migracionit ose përmes përdorimit të dokumenteve jo adekuate (false) për të hyrë në territorin e shtetit tonë.

Sipas ligjit për Azilin, kompetente për të vendosur lidhur me kërkesat për Azil është Ministria e Punëve të Brendshme, gjegjësisht:

- Departamenti për Shtetësi Azil dhe Migracion-si shkallë e parë,
- Komisioni Kombëtar për Refugjatë-si shkallë e dytë,
- Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në Konflikt Administrativ.

Në pajtim me Ligjin për Azil, Ministria e Punëve të Brendshme, me akte nënligjore ka rregulluar procedurat dhe standardet për trajtimin e azil kërkuesve në pajtim me dispozitat dhe parimet e përcaktuara me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë direkt të zbatueshme në Republikën e Kosovës, si dhe Konventën e vitit 1951 për Statusin e Refugjatëve si dhe standardet

ndërkombëtare të zbatueshme.

E tërë procedura dhe standardet e pritjes dhe trajtimit fillestar të azilkërkuesit, (shqyrtimi i kërkesës për azil) janë rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 16/2013. Me këtë Udhëzim Policia Kufitare, është e obliguar t'iu ofrojnë informata lidhur me procedurat për azil të huajve apo personave pa shtetësi, të cilët hyjnë në Republikën e Kosovës.

Është me rëndësi të theksojmë se në Republikën e Kosovës, mbrojtja e të drejtave individuale të garantuara me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me Konventën e vitit 1951 lidhur me statusin e Refugjatit, do të përbëjnë minimumin e standardeve të mbrojtjes, të cilat duhet ti lejohen një azil kërkuesi.

Ligji në fuqi, gjithmonë do të interpretohet në frymën e minimumit të lartë përmendur të standardeve të mbrojtjes. Personi i cili kërkon azil në Kosovë sipas Ligjit për Azil, i ofrohet ndihma e nevojshme. Azilkërkuesi mund të kërkojë azil në gjuhën të cilën ai e kupton dhe nga ai nuk kërkohet që kërkesën për azil ta bëjë në ndonjë nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Azilkërkuesi do të informohet për procedurën e përcaktimit dhe njohjen e azilit, për të drejtat dhe detyrimet e tij në një procedurë të tillë, si dhe për të drejtën të kontaktoj Komisararin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë-UNHCR-në dhe ndonjë organizatë jo qeveritare, të cilat ju ofrojnë ndihmë azilkërkuesve.

Gjithashtu azilkërkuesi ka të drejtë të zgjedhë një përfaqësues ligjorë, i cili do ta ndihmojë dhe përfaqësojë atë gjatë procedurës për përcaktimin e azilit, me shpenzime të azil kërkuesit. Përfaqësuesi ligjorë i azilkërkuesit si dhe përfaqësuesi i zyrës së UNHCR-së, kanë të drejtë të kontaktojnë azilkërkuesin në çdo kohë dhe në secilën fazë të procedurës për përcaktimin e azilit. Azilkërkuesi ka të drejtë të flasë me përfaqësuesin e tij ligjorë ose përfaqësuesin e UNHCR-së, në çdo kohë si dhe të jetë i informuar për këtë të drejtë.

Azilkërkuesi pas paraqitjes së kërkesës për azil dhe marrjes së njohurive të drejtohet pranë organit kompetent DSHAM-së, me qëllim të regjistrimit të tij, marrjes së gjurmëve të gishtërinjve, fotografisë, dhe plotësimin e formularit fillestar të përzgjedhjes për azil. Azilkërkuesi do të njoftohet nga Qendra për azilkërkues lidhur me të drejtat dhe detyrimet të cilave azilkërkuesi duhet të ju përmbahet me rastin e akomodimit në Qendrën për Azilkërkues, ky njoftim i bëhet në gjuhën të cilën e kupton, nëse është e nevojshme informacioni i tillë i jepet edhe verbalisht.

DASHM, brenda afatit prej 3 (tre) ditësh, do ti lëshoj azilkërkuesit një certifikatë të statusit të tij në Kosovë. Ndërsa brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh, do ti lëshojë letërnjoftimin e azilkërkuesit. Ky dokument do ti lëshohet për aq kohë sa do të zgjasë procedura e azilit. Azilkërkuesi mund të pajiset edhe me dokumente të udhëtimit në rastet kur paraqiten arsye serioze humanitare që kërkojnë praninë e azilkërkuesit në një shtet tjetër.

Pas plotësimit të formularit nr.1, dhe kryerjes së procedurave të përmendura më lartë azilkërkuesi e plotëson formularin nr.3, për përcaktimin statusit të mbrojtjes, pastaj zyrtari për azil cakton datën e intervistës dhe e njofton azilkërkuesin lidhur me datën e intervistës.

Procedurat, standardet e shqyrtimit dhe marrjes së vendimit lidhur me kërkesën për azil

Duke u bazuar në Ligjin për Azilin, Ministria e Punëve të Brendshme, me Udhëzimin Administrativ nr. 17/2018, ka rregulluar procedurën dhe standardet për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit lidhur me kërkesën për azil.

Me këtë Udhëzim, pas përfundimit të procedurës lidhur me parashtrimin e kërkesës për azil nga ana e azilkërkuesit si dhe pas dorëzimit të formularëve të plotësuar, zyrtari përgjegjës për zhvillimin e procedurës do ta regjistroj formularin përkatës në bazën e të dhënave.

Intervista me azilkërkuesin do të planifikohet të mbahet në një afat të arsyeshëm dhe jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e parashtrimit të kërkesës për azil.

Ftesa për intervistën do të dorëzohet azil kërkuesit së paku 4(katër) ditë para ditës kur është planifikuar të zhvillohet intervista. Zyrtari përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës do të njoftoj lidhur me intervistën e paraparë në pajtim me ligjin edhe përfaqësuesin e autorizuar, kujdestarin ligjorë për fëmijën e pashoqëruar, kujdestarin për personat me aftësi të zvogëluar mendore, përfaqësuesin e UNHCR-së dhe përkthyesin.

Zyrtari përgjegjës para fillimit të intervistës për shqyrtimin e kërkesës së azilit do të bëjë një vlerësim të plotë të dosjes së azilit.

Si zhvillohet procedura e intervistës..?

Lidhur me kërkesën për azil, procedura e intervistës me azil kërkuesin do të zhvillohet në kushte konfidenciale dhe do të jetë e mbyllur për publikun, përjashtimisht prezent në procedurë mund të jenë: përfaqësuesi i autorizuar, përfaqësuesi ligjorë i fëmijës së pa shoqëruar, kujdestari për personat me aftësi të zvogëluar mendore, përfaqësuesi i UNHCR-së dhe përkthyesi.

Gjatë zhvillimit të intervistës azilkërkuesi do të njoftohet lidhur me procedurën e azilit, të drejtat dhe detyrimet në procedurë, parimin e konfidencialitetit, të drejtat dhe detyrimet për të deklaruar faktet dhe të vërtetën.

Gjatë kësaj interviste do të përcaktohet: identiteti i azilkërkuesit dhe anëtarje të tjerë të familjes që e shoqërojnë, baza e kërkesës për azil, mënyra e hyrjes në Kosovë dhe fakti nëse ka parashtruar kërkesë për azil në ndonjë shtet tjetër.

Në këtë fazë të procedurës përpilohet procesverbal lidhur me zhvillimin e intervistës me azil kërkuesin, i cili nënshkruhet nga azil kërkuesi për të konfirmuar vërtetësinë pasi që ti jetë komunikuar në gjuhën të cilën ai e kupton si dhe nga akteret e tjerë pjesëmarrës në intervistë. Pas përfundimit të intervistës merren informata nga vendi i origjinës përmes të cilave me rastin e vendim marrjes për përcaktimin e statusit të azil kërkuesit, do të njoftohen lidhur me situatën politike, sociale, kulturore, ekonomike, respektimin e të drejtave të njeriut, legjislacionin e aplikueshëm në vendin e origjinës së personave të cilët kërkojnë azil.

Organet kompetente për vendosjes e kërkesë për Azil

Lidhur me kërkesën për azil është kompetente të vendos Ministria e Punëve të brendshme dhe atë:

- Departamenti për Shtetësi AZIL dhe Migrim –si organ i shkallës së parë
- Komisioni Kombëtar për Refugjat-si organ i shkallës së dytë dhe
- Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Administrative-lidhur me padinë

Në shkallë të parë vendos Departamenti për Shtetësi Azil dhe Migrim, i cili pas shqyrtimit të kërkesës mund të merr këto vendime:

- E aprovon kërkesën dhe e njehë të drejtën e azilit
- E refuzon kërkesën për azil dhe e njehë mbrojtjen plotësuese
- E refuzon kërkesën për azil
- E ndërpre në procedurën e azilit.

Vendimet lidhur me kërkesën për njohjen e azilit do të merret në formë të shkruar, me arsye ligjore për vendim marrjen, si dhe me këshillën juridike lidhur me ushtrimin e ankesës.

Vendimi azil kërkuesit i dorëzohet në afat prej 5 (pesë) ditësh, nda dita e marrjes së vendimit lidhur me kërkesën për azil. Dorëzimi dhe komunikimi i vendimit azil kërkuesit do ti bëhet përmes zyrtarit përgjegjës të rastit në një gjuhë të cilën ai e kupton, në rastet kur azil kërkuesi ka përfaqësues të autorizuar dorëzimi dhe komunikimi i vendimit i bëhet përmes tij.

Pasi që vendimi lidhur me refuzimin e kërkesës për të drejtën e azilit apo për ndërprerjen e procedurës së azilit, të ketë marrë formën e prerë, zyrtari përgjegjës për zhvillimin e procedurës do ta inventarizoj dosjen përkatëse dhe të njëjtën do të ia dorëzojë Divizionit për Kthim dhe Ri pranim, me qëllim të organizimit të kthimit, i cili do të njoftohet me shkrim lidhur me dosjen përkatëse. Dosja e azilit do të mbyllet një muaj pasi që procedura e azilit të ketë përfunduar.

Njohja, refuzimi dhe pushimi i azilit

Njohja e Azilit,

Duke u nisur nga fakti se azili është një e drejtë e garantuar sipas Ligjit, si e tillë kjo e drejtë do ti lejohet të huajit apo personit pa shtetësi, për të cilin është përcaktuar se i plotëson kriteret e përkufizimit të azilit dhe nuk ekzistojnë shkaqet e përjashtimit nga kjo e drejtë sipas këtij ligji.

Në rastin kur azil kërkuesit, iu ka njohur e drejta e azilit në Kosovë dhe gëzon statusin e azilantit, atij automatikisht i njihen një mori të drejtash konform nenit 19 të Ligjit për Azilin.

Në bazë të Ligjit, personat që gëzojnë statusin e azilantit përveç të drejtave në Kosovë kanë edhe detyrime. Ata obligohen që të veprojnë në pajtim me rendin kushtetues, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në Republikën e Kosovës, të njoftojnë organin kompetent brenda 7 (shtatë) ditësh lidhur me vendin e tij/saj të banimit si dhe çdo ndryshim të adresës dhe të njoftojnë organin kompetent për punësimin në të cilin janë të angazhuar.

Refuzimi i kërkesës për azil,

Një personi nuk do ti njihet e drejta e azilit, nëse ekzistojnë arsye serioze, për tu konsideruar se i njëjti:

- Ka kryer krim kundër paqes, krim lufte ose krim kundër njerëzimit, të definuar me aktet ndërkombëtare dhe normat e tyre lidhur me krimet e tilla,
- Ka kryer krim të rëndë jo politik jashtë Kosovës para ardhjes në Kosovë,
- Është fajtorë për vepra në kundërshtim me parimet dhe objektivat e Kombeve të Bashkuara.

Pezullimi i procedurës për azil,

Me vendim organi kompetent e pezullon procedurën e azilit në rastet kur:

- Azil kërkuesi heq dorë nga kërkesa për azil,
- Kur azil kërkuesi largohet nga vend qëndrimi i fundit për më shumë se 3 (tre) ditë pa e njoftuar organin kompetent për ndryshimin e adresës,
- Azil kërkuesi largohet nga Republika e Kosovës, gjatë procedurës.

Në rastet e pezullimit të procedurës me vendim, azil kërkuesi në këto raste mund të bëjë kërkesë për rihapjen e procedurës, vetëm në rast se paraqet arsye të bazuara lidhur me këtë.

Kërkesa për rihapjen e procedurës së azilit e ndalon dëbimin e të huajit nga Kosova.

Heqja e të drejtës së azilit apo pushimi i të drejtës,

Sipas Ligjit për Azil, azili mund të përfundojë përmes procedurës së pushimit të azilit, nga ana e organit kompetent për personin të cilit i është njohur e drejta e azilit në Republikën e Kosovës.

E drejta e azilit, me vendim të organit kompetent pushon në këto raste:

- Në mënyrë vullnetare e kthen vehten në mbrojtje të vendit të shtetësisë,
- Pas humbjes së shtetësisë së tij, vullnetarisht e ka ri fituar atë,
- Merr shtetësi të re dhe e gëzon mbrojtjen e vendit, shtetësinë e të cilit e ka marrë,
- Vullnetarisht është vendosur në vendin prej të cilit ka ikur për shkak të frikës nga përndjekja,
- Nuk mund të vazhdon të refuzojë mbrojtjen e vendit të shtetësisë, për shkak se kushtet në bazë të cilave i është njohur e drejta e azilit, kanë pushuar të ekzistojnë,
- Për personat pa shtetësi, nëse i njëjti është në pozitë për tu kthyer në vendbanimin tij të përhershëm, ngase kushtet që e kanë bërë të mundur njohjen e të drejtës së azilit kanë pushuar së ekzistuari,
- Azili mund të ndërpritet kur i huaji është dashur të përjashtohet nga e drejta për statusin e tillë për arsyet e saktësuara me ligjin për Azilin, ose për shkak të keq interpretimit të mungesës së fakteve, duke përfshirë shfrytëzimin e dokumenteve të rrejshme, që është arsye e bazuar për njohjen e të drejtës së azilit.

Procedura e Ankesës,

Procedura e azilit lidhur me vendosjen e kërkesës për njohjen e azilit, në shkallë të parë si rregull zgjatë 6 (gjashtë) muaj, nga dita e parashtrimit të kërkesës për azil. Vendimet e marra në procedurën e përshpejtuar (neni 52) i Ligjit, si rregull duhet të merren brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga paraqitja e kërkesës për azil.

DSHAM-ja, i dorëzon vendimin azilkërkuesit në afat prej 5 (pesë) ditësh, nga dita e marrjes së vendimit lidhur me kërkesën.

Azil kërkuesi, personi me status refugjati, personi nën mbrojtje plotësuese apo personi nën mbrojtje të përkohshme, kanë të drejtë që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, të parashtrorjnë ankesë kundër vendimit të shkallës së parë, nga dita e marrjes së vendimit, përveç rasteve të parashikuara ndryshe me ligj, në Komisionin Kombëtarë për Refugjat si organ i shkallës së dytë kompetent për të vendosur lidhur me ankesën.

Në ankesë duhet të theksohet numri dhe data e vendimit të cilit i referohet, pas pranimit të ankesës, komisioni së pari vërteton nëse ajo është bërë në afat ligjorë të përcaktuar me nenin 65 të Ligjit për Azil dhe nëse ajo është bërë nga personi i autorizuar. Ankesa e ushtruar jashtë afatit ligjorë dhe nga personi ipa autorizuar hedhet poshtë me vendim nga ana e Komisionit. Pala ankuese duhet të paraqes faktet dhe argumentet ligjore që nuk janë shqyrtuar më parë nga organi i shkallës së parë ose të pohojë se organi i shkallë së parë ka bërë shkelje faktike, ligjore dhe procedurale gjatë marrjes së vendimit.

Ankesa duhet ti specifikoj shkaqet dhe arsyet për ankim imin e aktvendimit të shkallës së parë, e të cilat janë:

- Shkelje të dispozitave të drejtës procedurale
- Konstatim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike,
- Shkelje e dispozitave të drejtës materiale,
- Fakte të reja të rëndësishme në mbështetje të kërkesës.

Pala ankuese në ankesë, duhet gjithashtu të propozojë propozimin konkret lidhur me çështjen e cila është objekt shqyrtimi. Sekretaria do ti dorëzojë komisionit kopjen e dokumenteve jo më vonë se 3 (tre) ditë, para seancës në të cilën do të shqyrtohet ankesa, dosjes duhet ti bashkëngjiten:

- Vendimi ndaj të cilit parashtrrohet ankesa,
- Ankesën së bashku me dokumentacionin mbështetës (dosjen e lëndës)

Barra e paraqitjes së provës mbi të cilat mbështetet ankesa bie mbi palën e cila e ka ushtruar ankesën. Komisioni nëpërmjet sekretarisë i njofton palët me shkrim mbi kohën, datën dhe vendin ku do të mbahet seanca së paku 3 (tre) ditë para mbajtjes së seancës. Seanca para komisionit është e tipit të mbyllur. Palët në seancë janë parashtruesi i ankesës dhe komisioni. Në seancë për shqyrtimin e ankesës merr pjesë përfaqësuesi i UNHCR-së, në cilësinë e vëzhguesit. Kryetari i Komisionit e udhëheqë seancën, komisioni mund të kërkojë prova shtesë lidhur me çfarëdo çështje që parashtrrohet nga cilado palë gjatë procedurës.

Komisioni si organ i shkallës së dytë, merr këto vendime:

- Miraton vendimin e shkallës së parë-refuzon ankesën,
- Anulon vendimin e shkallës së parë dhe të njëjtin e kthen në rishqyrtim, aprovon ankesën,
- Përmirëson mangësitë e konstatuara dhe merr vendimin, (e ref. Ankesën)
- Bënë ndryshimin e vendimit të shkallës së parë mbi bazën e të njëjtave prova. (vetë e vendos çështjen)

Komisioni ankesën e shqyrton në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita kur është parashtruar ankesa, përveç rasteve të ankesave kundër vendimeve të marra konform nenit 55 të Ligjit për Azil, kur kërkesa për azil është e pabazuar, komisioni duhet të vendos në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e parashtrimit të ankesës. Vendimi bëhet i plotë fuqishëm në ditën kur i dorëzohet parashtruesit të ankesës. Vendimi i komisionit është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe se i njëjti mund ti nënshtrohet shqyrtimit gjyqësorë , në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me padi.

Ankesa e ushtruar kundër vendimit të organit të shkallës së parë dhe padia e ushtruar kundër vendimit të organit të shkallës së dytë e pezullon ekzekutimin e vendimit konform nenit 64. Par.3 të Ligjit për Azilin.

Mbrojtja Plotësuese

Mbrojtja Plotësuese-është mbrojtje që i ofrohet shtetasit të huaj apo personit pa shtetësi edhe pse nuk i përmbush kriteret e përcaktimit të statusit të refugjatit, ka arsye serioze dhe të bazuara të mendohet se në rast të kthimit të tij në vendin e origjinës apo prejardhjes apo në rastin e personit pa shtetësi në vendin e tij apo saj të banimit të mëparshëm të rregullt, ai rrezikon realisht të përballlet me cenime të rënda dhe nuk ka mundësi apo për shkak të rrezikut të tillë nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi. Cenime të rënda konsiderohen:

- Dënimi me vdekje apo ekzekutimi
- Tortura apo trajtimi ose dënimi çnjerëzor apo degradues i aplikuesit në vendin e origjinës dhe
- Kërcënimi serioz dhe individual ndaj jetës së një civili apo personi për shkak të dhunës pa dallim në situata të konfliktit të armatosur ndërkombëtar apo të brendshme.

Republika e Kosovës ia ofron mbrojtjen plotësuese shtetasit të huaj apo personit pa shtetësi i cili nuk i përmbush kriteret e përcaktimit të statusit të refugjatit, por i plotëson kriteret e përcaktuara në përkufizimin e mbrojtjes plotësuese të parapara me nenin 3 të Ligjit për Azilin. Sa më parë që është e mundur pasi që statusi i tyre është i njohur Ministria do tiu lëshojë përfituesve të statusit të mbrojtjes plotësuese një leje banimi e cila duhet të jetë e vlefshme së paku një(1) vit me mundësi vazhdimi, përveç nëse arsyet imponuese të sigurisë shtetërore apo rendit publik kërkojnë ndryshe.

Përgjashtimi nga mbrojtja plotësuese- kjo e drejtë nuk do ti njohët personit për të cilin ka arsye serioze të konsiderohet se:

- Ka kryer krime kundër paqe, krime lufte, ose krime kundër njerëzimit në kuptim të dispozitave ndërkombëtare që përcaktojnë këto krime,
- Ka kryer krime të rënda,
- Është fajtor për akte që janë në kundërshtim me qëllimet apo parimet e Kombeve të Bashkuara, sipq parashihet në preambulë dhe nenet 1 dhe 2 të KB dhe
- Paraqet rrezik për bashkësinë ose sigurinë e R. Kosovës.
- **Parashtrimi i aplikacionit për mbrojtje ndërkombëtare**
- Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë të paraqesin aplikacion për mbrojtje ndërkombëtare në çdo kohë.
- Aplikacioni sipas paragrafit 1. të këtij neni do të shqyrtohet pas përfundimit të mbrojtjes së përkohshme

Përfundimi i mbrojtjes së përkohshme

Mbrojtja e përkohshme do të përfundojë në këto raste:

- pas përfundimit të afatit për të cilin i është lejuar mbrojtja e përkohshme;
- pas vendimit të Qeverisë lidhur me pushimin e arsyeve për dhënien e mbrojtjes së përkohshme.

Roli i UNHCR-së

Organet shtetërore do ta lejojnë UNHCR-në:

- Të ketë qasje tek aplikuesit, duke përfshirë edhe ata nën arrest, në aeroport, kufi dhe në zona tranziti,
- Të ketë qasje në informata, të aplikacioneve individuale për mbrojtje ndërkombëtare, në zhvillimin e procedurave dhe në vendimet e marra duke siguruar që aplikuesi ka shprehur pajtimin,
- Të paraqes pikëpamjet e veta, si zbatim i përgjegjësive mbikëqyrëse sipas nenit 35 të Konventës së Gjenevës ndaj cilit do organ kompetent, lidhur me aplikacionet individuale për mbrojtje ndërkombëtare në çdo fazë të procedurës.

Lejimet do të zbatohen gjithashtu për organizatën e cila punon në emër të UNHCR-së, në territorin e R. Kosovës sipas një marrëveshje me Qeverinë e Kosovës.

Konflikti administrativ në çështjet e të drejtës së Azilit,

Inicimi i Konfliktit Administrativ dhe vendimi i Gjykatës,

Procedura gjyqësore në Gjykatë, lidhur me çështjen e azilit, zhvillohet sipas Ligjit për Konfliktet Administrative, (LKA)-së, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Qështje Administrative.

Padia paraqitet brenda **30 ditësh**, nga dita e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtarë palës, ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Ndërsa nëse akti administrative nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padi brenda **60 ditësh**, nga dita e dorëzimit të aktit administrative pales, në favor të së cilës është nxjerrë akti. (neni 27)

Nëse organi i shkallës së dytë (Komisioni Kombëtar për Refugjatë), nuk e ka nxjerrë vendimin brenda **30 ditësh**, ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veqanta rreth ankimit të pales kundër vendimit të organit të shkallës së parë (DSHAM), ndërsa nuk e nxjerrë as në afatin prej 7 ditësh me kërkesën e përsëritur, pala ka të drejtë të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i ishte refuzuar ankesa.(neni 29)

Në kuptim të (nenit 13) të Ligjit për Konfliktin Administrativ:

“konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë” çka do të thotë vetëm kundër vendimit përfundimtar të **Komisionit Kombëtarë për Refugjatë**. Ndërsa në par. 2 të këtij neni përcaktohet se: *“konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurë administrative ankimi nuk është i lejuar”* e që në çështjet e azilit nuk vlenë sepse e kemi dyshkallëshmërinë e organeve të administratës.

Gjithashtu (neni 14) i po këtij Ligji parasheh se: *“konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës së pales, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj”*.

Sipas LKA-së (neni 16), akti administrativ mund të kundërshtohet me padi në procedurën e konfliktit administrativ:

- për shkak të mos aplikimit ose të aplikimit jo të drejtë të dispozitave ligjore,
- për shkak se akti është nxjerrë nga organi jo kompetent,
- për shkak se në procedurën që i ka prapirë nxjerrjes së aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.
- për shkak se me aktin përfundimtarë administrativ, të nxjerrë sipas vlerësimit të lirë, organi i ka tejkalar kufijtë e autorizimit ligjorë ose akti i tillë nuk është nxjerrë në pajtim me qëllimin e këtij ligji apo
- për shkak se pala e paditur e ka nxjerrë përsëri aktin e vetë të mëhershëm, më parë të anuluar me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës kompetente.

Në konfliktin administrativ (neni 38), gjykata si rregull, vendosë në seancë të hapur mirëpo gjykata vendos në seancë të mbyllur në rast se mund të zbulohen fakte që kanë të bëjnë me jetën private të palëve, sekretin shtetëror, profesional, tregtar etj. Mirëpo gjykata mund të vendosë për përjashtimin e publikut nga seanca, në bazë të vlerësimit të vet me vendim procedural, i cili ju komunikohet palëve.

Nga kjo dispozitë gjykohen edhe çështjet e azilit gjykata vendos nëse seanca do të jetë e mbyllur ose jo, varësisht nga ndjeshmëria e rastit që gjykohet, ku pale në procedurë janë pala që ka parashtruar padinë dmth, azil kërkuesi dhe Komisioni Kombëtar për Refugjat, vendimit të të cilit I vlerësohet ligjshmëria.

Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, në bazë të fakteve dhe provave të vërtetuara në procedurë administrative.

Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar, shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë. Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykat në konfliktin administrativ vendos me aktgjykim me të cilin:

- padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar,
- nëse padia aprovohet gjykata e anulon aktin administrativ të kontestuar.

Nëse gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të **anulohet**, atehere qeshtja kthehet në rishqyrtim tek organi i paditur i administratës, i cili është i obliguar që mbrenda afatit prej 30 ditësh të nxjerr vendimin sipas vërejtjeve të gjykatës. Mirepo gjykata mundet nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurtë për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar.

Kundër vendimit të gjykatës –Departamentit për Qështje Administrative, ankesa i paraqitet gjykatës së Apelit-Departamentit për Qështje Administrative, në afat prej **15 ditësh**, nga dita e pranimit të vendimit të gjykatës.

Mjetet juridike në procedurën gjyqësore në Konflikt Administrativ

Në bazë të ligjit për konfliktet administrative janë përcaktuar mjetet e rregullta juridike – ankesa dhe mjetet e jashtëzakonshme, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe kërkesa për rishikim.

Ankesa

Në procedurën e konflikteve administrative, kundër vendimit të gjykatës mund të ushtrohet mjete i rregullt juridik siç është ankesa, vetëm atëherë kur shprehimisht e ka përcaktuar Ligjit për Konfliktet Administrative. Kur ankesa lejohet ajo mund të paraqitet në afat prej 15 ditësh, që nga dita e pranimit të vendimit të gjykatës. Të drejtën e paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit në konflikt administrativ kanë: Pala e paditur, pala paditëse si dhe personi i interesuar.

I padituri organi i cili ka nxjerrë vendimin administrativ mund të ushtrojë ankesë kur vendimi i tij është anuluar në konfliktin administrativ. Ankesë mund të paraqes edhe pala paditëse, i cili është i

pakënaqur me vendimin gjyqësor të gjykatës për refuzimin e padisë, në rastet kur gjykata refuzon padinë. Ankesë mund të paraqet edhe personi i interesuar, po që se është i pakënaqur me vendimin gjyqësor të nxjerrë në konfliktin administrativ.

Forma dhe Përmbajtja e Ankesës

Ankesa duhet të përmbajë elementet themelore të saj. Në ankesë duhet të theksohet vendimi gjyqësor që goditet me ankesë dhe shkaqet e goditjes të vendimit gjyqësor. Gjykata pasi që pranon ankesën duhet ta shqyrtoj anën formale të saj, nëse konstaton se ankesa është e palejueshme, e paraqitur pas afatit ose e paraqitur nga personi i pa autorizuar, me vendim e hedh poshtë ankesën. Nga kjo rezulton se gjykata fillimisht duhet të shqyrtojë këto elemente të ankesës. Nëse konstaton se nuk ka mangësi lidhur me këto elemente atëherë gjykata duhet që ta shqyrtoj ankesë, dhe atë duke u bazuar në dispozitat e nenit 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ ku thuhet se nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, përshtatshmërisht t duhet të zbatohet Ligji i Procedurës Kontesti more. Në rastin konkret duhet të zbatohen dispozitat e nenit 194 gjer në nenin 210 të LPK-së. Gjykata e shkallës së dytë me rastin e shqyrtimit të ankesës mund ta hedh poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme, ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë, ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe të vërtetë aktgjykimin e goditur, ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.

Në qoftë se gjykata e aprovon ankesën si të bazuar dhe e prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, në këtë rast lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, vërejtjet dhe sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë janë obligative për gjykatën e shkallës së parë kur të vendos në rigjykim dhe rivendosje, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë duhet të zhvillojë të gjitha veprimet procedurale dhe ta shqyrtojë çështjen sipas asaj si e ka përcaktuar gjykata e instancës së shkallës së dytë duke vendosur lidhur me ankesën.

Mjetet e Jashtëzakonshme Juridike

Mjetet e jashtëzakonshme juridike palët mund ti shfrytëzojnë pasi që gjykata ka vendosë në mënyrë meritore dhe se aktgjykimi do ta merrte formën e prerë. Ligji për Konfliktet Administrative i ka përcaktuar tri mjete të jashtëzakonshme juridike dhe ato janë:

1. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor
2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
3. Rishikimi.

Kërkesa për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, si mjet juridik i jashtëzakonshëm, mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe atë i dërgohet gjykatës brenda 30 dite, nga data e pranimit të vendimit të formës së prerë kundër të cilit pala paraqet kërkesën. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm sipas dispozitave të ligjit për konfliktet administrative duhet të përmbajë emërtimin e aktgjyimit të gjyqësorit, si dhe shkaqet dhe vëllimin në të cilin propozohet rishqyrtimi. Ky mjet i jashtëzakonshëm juridik mund të ushtrohet për shkak të shkeljes së dispozitave materialo-juridike si dhe për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës.

Kompetente për vendosje lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjyimit të formës së prerë është Gjykata Supreme konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-199. Nëse kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm nuk është e plotë, e pa kuptueshme ose ka të meta, gjyqtari vepron

në kuptim të nenit 33 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, duke ia kthyer ushtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm që në afat prej 8 ditësh ti mënjanoj të metat. Nëse ushtruesi i kërkesës brenda afatit të cekur nuk i mënjanon të metat, gjykata do ta hedh poshtë kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të formës së prerë. Nëse gjykata nuk e hedh kërkesën, atëherë ajo do t'ia dërgoj palës së kundërt, e cila brenda afatit prej 15 dite, mund të jap përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm. Gjukata kundër vendimit të së cilës është paraqitur kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kanë për detyrë që me kërkesën e gjykatës t'ia dërgojnë të gjitha shkresat e lëndës.

Gjukata vendos mbi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në seancë të mbyllur, gjersa vendimin e kundërshtuar e shqyrton vetëm brenda kufijve të kërkesës. Gjukata me aktgjykim refuzon ose e aprovon kërkesën. Me aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesa gjykata mund ta anuloj ose ta ndryshoj vendimin gjyqësor kundër të cilit është paraqitur kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm. Nëse gjykata anulon vendimin gjyqësor lënda i kthehet gjykatës, vendimi i së cilës është anuluar. Kjo gjykatë e ka për detyrë ti ndër marrë të gjitha veprimet procedurale dhe ti shqyrtoj çështjet për të cilat e ka sugjeruar gjykata që ka vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm.

Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë

Prokuroi i shtetit të Kosovës nëse konstaton se është shkelur ligji, dispozitat tjera apo akti i përgjithshëm ka mundësi të paraqes kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe atë në afat brenda 90 dite, nga data kur iu është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë. Bazë për paraqitjen e kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë është ekzistimi i shkeljes së ligjit pavarësisht se me aktin administrativ në favor të kujt është vendosur, të personit fizik apo personit juridik, mirëpo nëse është vendos edhe në dëm të interesit publik. Për këtë arsye të gjitha organet administrative dhe institucionet të cilat ushtrojnë autorizime publike kanë detyrim që ta njoftojnë prokurorin e shtetit të Kosovës me akte të cilat janë shkelur ligji në dëm të interesit publik. Vendimi i gjykatës i cili mund të goditet me këtë mjet juridik është aktgjykimi, përkatësisht aktvendimi i kolegjit të Gjykatës Supreme. Për të gjitha çështjet procedurale lidhur me mjetin juridik të jashtëzakonshëm siç është kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë zbatohen procedurat lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të formës së prerë.

Rishikimi

Në bazë të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative pala e interesuar mund të kërkojë risimin e vendimit që ka marrë formën e prerë dhe atë kur plotësohen kushtet:

1. Kur pala mëson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të ishin shkruar ose përdorur këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore.

2. Vendimi i gjykatës ka ardhur si pasojë e veprës penale të gjyqtarit apo punëtorit në gjykatë ose vendimi është nxjerrë me veprim mashtrues të përfaqësuesit ose të autorizuesit të palës, të kundërshtarit të tij ose të përfaqësuesit apo të autorizuarit të kundërshtarit, kurse ky veprim përbënë vepër penale.

3. Vendimi është bazuar në aktgjykimin e nxjerrë në çështje penale apo civile kurse ky aktgjykim është anuluar më vonë me vendim gjyqësor të formës së prerë.

4. Dokumenti në të cilin bazohet vendimi është i falsifikuar, apo nëse dëshmitari, eksperti, ose pala gjatë dëgjimit para gjykatës ka dhënë deklaratë të rremë, kurse vendimi i gjykatës është bazuar në këtë deklaratë.

5.Pala konstaton apo krijon mundësi ta përdor vendimin e mëparshëm ta nxjerrë në të njëjtin konflikt administrativ.

6.Personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marr pjesë në konflikt administrativ.

Nga pika 1 deri në pikan 5 rishikimi do të lejohet vetëm nëse pala, pa faj të vetë, nuk ka pasur mundësi që këto rrethana ti shtrojë në procedurën e mëparshme.

Rishikimi i vendimeve në kushtet e cekura më lart lejohet kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente për pikën 2 dhe 4.

Rishikimi i vendimeve mund të kërkohet jo më vonë se brenda 30 ditësh nga data kur pala të ketë mësuar për shkakun e rishikimit. Nëse pala ka mësuar për shkakun e rishikimit para se të ketë marrë fund procedura para gjykatës , gjersa për këtë shkak nuk ka mundur ta përdorë gjatë procedurës, rishikimi mund të kërkohet brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të vendimit. Afati subjektiv për ushtrimin e kërkesës për rishikim është 30 ditë, nga data kur pala të ketë mësuar për shkakun e rishikimit. Gjersa afati objektiv është pasi të kenë kaluar 3 vjet nga data kur vendimi të ketë marrë formën e prerë, rishikimi nuk mund të kërkohet. Kompetente për të vendosur lidhur me kërkesën për rishikim vendos gjykata që ka nxjerr vendimin.

Forma dhe Përmbajtja e kërkesës

Kërkesa për rishikim duhet të përmbajë aktgjykimin ose vendimin i cili është nxjerr në procedurën e konfliktit administrativ, rishikimi i të cilit kërkohet.

Baza ligjore e rishikimit, provat dhe rrethanat që e bëjnë të besueshëm ekzistimin e kësaj baze për rishikim.

Rrethanat nga të cilat rezulton se kërkesa është paraqitur në afatin ligjor, dhe me cilat prova vërtetohet.

Në cilin drejtim dhe në cilin vëllim propozohet ndryshimi i aktgjykimit respektivisht i vendimit të nxjerr në procedurë, rishikimi i të cilit kërkohet.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të kërkesës për rishikim, vendosë në seancë të mbyllur. Gjykata fillimisht duhet të vërtetoj se kërkesën e ka paraqitur personi i autorizuar ose kërkesa për rishikim është ushtruar në kohën e duhur, apo pala e ka bërë të paktën të besueshëm ekzistimin e bazës ligjore për rishikim. Nëse këto tri elemente nuk janë plotësuar atëherë gjykata duhet ta hedh poshtë kërkesën me vendim. Pas vërtetimit të këtyre elementeve gjykata kërkesën për rishikim ia dërgon palës kundërshtare i cili brenda 15 ditësh duhet ti përgjigjet kërkesës për rishikim. Pas skadimit të këtij afati për përgjigje në kërkesë për rishikim, gjykata vendosë me aktgjykim mbi kërkesën për rishikim. Nëse lejohet kërkesa për rishikim do të shfuqizohet (anulohet) vendimi i atakuar me kërkesë për rishikim.

Karakterit i Detyrueshëm i Aktgjykimin në Konfliktin Administrativ

Ligji për konfliktet administrative ka përcaktuar se kur gjykata e anulon aktin administrativ, kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, lënda i kthehet të njëjtit organ i cili ka nxjerrë aktin e mëparshëm, të cilin gjykata tani e ka anuluar. Nëse sipas karakterit të çështjes, që ka qenë objekt i konfliktit, duhet që në vend të aktit të anuluar administrativ, të nxirret një tjetër akt sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të cilat i kishte dhënë gjykata me rastin e anulimit të aktit administrativ. Organi

kompetent ka për detyrë ta nxjerrë aktin e ri për shtyrje, jo më vonë se brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të aktgjykimit.

Pas nxjerrjes së aktgjykimit, nga ana e gjykatës kompetente në konfliktin administrativ, lindin tri situata të ndryshme dhe atë:

1. Organi vepron në përputhje me vërejtje dhe sugjerime të gjykatës dhe se me atë veprim nxjerr aktin e ri administrativ.
2. Organi kompetent nxjerr akt të ri administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës të dhënë në aktgjykim.
3. Organi në afatin e caktuar fare nuk nxjerr akt të ri administrativ edhe pse ka qenë i detyruar për këtë.

Në qoftë se organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ e nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, paditësi mund të parashtroj padi të re, gjykata mund të anuloj aktin e kontestuar, me aktgjykim i cili krejtësisht e zëvendëson aktin administrativ të anuluar.

Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerr aktin administrativ brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të aktgjykimit, pala me parashtrësë të veçantë mund të kërkoj nxjerrjen e aktit duke kërkuar nga organi administrativ që të veprojë konform dispozitës së nenit 65 të Ligjit për konfliktet administrative.

Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerrë menjëherë e jo më vonë se 30 ditë, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të nxjerrë pala mund të kërkojë me parashtrësë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë.

Nëse organi kompetent nuk e nxjerr aktin brenda 7 ditësh nga kjo kërkesë, pala mund të kërkojë nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që ka nxjerrë aktgjykimin.

Gjykata duke u bazuar në kërkesën e palës do të kërkojë nga organi kompetent njoftimin mbi shkaqet për të cilat organi administrativ nuk e ka nxjerrë aktin e ri.

Organi kompetent ka për detyrë ta jap këtë njoftim menjëherë, jo më vonë se brenda 7 ditësh. Nëse organi administrativ nuk e bënë këtë, apo nëse njoftimi i dhënë sipas mendimit të gjykatës nuk e arsyeton moszbatimin e arsyetimit të gjykatës, gjykata do të nxjerrë vendimin i cili e zëvendëson aktin e organit kompetent.

Vendimin e nxjerrë nga gjykata, do t'ia dërgojë organit kompetent që ushtron mbikëqyrjen. Organi administrativ kompetent për ekzekutim ka për detyrë që ta përmbarojë vendimin e gjykatës. Kur në konfliktin administrativ është nxjerrë aktgjykimin nga ana e gjykatës kompetente, gjersa organi ka nxjerrë aktin administrativ për ekzekutimin e këtij aktgjykimi, por pranë organit kërkohet rishikimi i aktgjykimit për këtë akt administrativ, rishikimi mund të lejohet nëse shkaku i rishikimit ka lindur pranë organit që e ka nxjerrë aktin administrativ.